

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Takimi me shqiptarët në SHBA - Berisha: Ata që firmosën ndalimin tim, sot janë non-grata! Mirënjohje pr esidentit Trump dhe sekretarit Rubio
ADRESA	https://www.syri.net/politike/914726/berisha-ata-qe-firmosen-ndalimin-tim-sot-jane-non-g-rata-ne-vendin-e-tyre-mirenjohje-presidentit-trump-dhe-sekretarit-rubio/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 16:14:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 15:58:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2212394d582ef439bf45dd362bdb9b44859fc5b55a142dc7a9253ca54e6f90e0
TEKSTI	f096eadee3ba058066d526d4960bbc4529dff5cbb974319eac05680b636c833
PAMJA	ed59d20a0398df1568a69d09eca574fa9bb86fc326412e71ff5ffe1ff446c4b7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f2ed509e5e72cf021db0030265de9b5f45bbb7506bb9fc5151c2621d70b47727
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3909e366fa48fb117e93d2c07d0f8b111d83fbadbc5fe5fb3b2f1229006811f8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f2ed509e5e72cf021db0030265de9b5f45bbb7506bb9fc5151c2621d70b47727>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Për ne](#)
- [Redaksia](#)
- [Marketing](#)
- [+355697009690](#)
- [Edicioni i Kosovës](#)
-
- [Lajme](#)
 - [Web TV](#)
 - [Kuriozitete](#)
 - [Arte & media](#)
 - [Sociale](#)
 - [English](#)
 - [Shëndet](#)
 - [Tjera](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Botë](#)
 - [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Shkencë](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Botërori 2026](#)
- [Jetë/stil](#)
- [Trashëgimi](#)
 - [Histori](#)
- [Mjedis](#)
 - [Klimë](#)
- [Op-Ed](#)
 - [Analizë](#)
 - [Blog](#)
- [PLUG](#)
-
- [Marketing](#)
- [+355697009690](#)

toggle menu

 [Lutfi Dervishi](#) [Lutfi Dervishi Udhëzues express për 'Praninë Besnike; Turi 60-minutësh i halleve!](#)

 [Armand Shkullaku](#) [Armand Shkullaku Fabula e re e Edi Ramës: Shqiptarëve pasqyrën për vete milionat](#)

LAJMI I FUNDIT

[LIVE - Dita e 99 e protestës në Tiranë, qytetarët kërkojnë dorëheqjen e Ramës](#)

-
-
-
-

Berisha: Ata që firmosën ndalimin tim, sot janë non-grata! Mirënjohje presidentit Trump dhe sekretarit Rubio

ZMADHO TEKSTIN 17:58, 06/09/2026



Kreu i Partisë Demokratike në fjalën e mbajtur me shqiptarët në Nju Xhersi u shpreh se ata që i përgatitën mashtroje ndaj tij dhe ndalimin për hyrjen në SHBA, sot janë pas hekurave.

Duke iu referuar ish-ambasadores në Tiranë, Yuri Kim, Berisha shton se ajo që dikur i tregonte shqiptarëve barin, sot është papunë. Berisha theksoi edhe një herë se pas goditjes me non-grata nga ekstremi i majtë në SHBA dhe Shqipëri ai vendosi të ringrihet, në të njëjtën kohë kur edhe Trump po bënte betejën e tij kundër Soros.

Berisha: *Për ne sot kjo është një ditë jo e zakonshme. Sot është një ditë që për mua përsëri ngjall emocione. Një ditë që shumëkush e ka menduar të pamundur. E ka menduar si një ditë që nuk do ta shihnim ndonjëherë. Sepse le të jemi të sinqertë.*

Shumë prej nesh të paktën një herë a më shumë kemi pyetur veten kush jemi ne, kush jemi ne për të sfiduar një padrejtësi.

Jo pak herë kemi pyetur veten këto vite:

Kush jemi ne?

Si zëri i një të drejte të dëgjohet në një botë ku për fat të keq gjithmonë e më shumë po sundohet nga e padrejta?

Kush jemi ne që të qëndrojmë të fortë kur në momente të caktuara e gjithë bota dukej kundër nesh? Këto janë pyetje që vërtet të bëjnë të ndihesh i vogël në një botë të madhe.

Këto janë pyetje që të bëjnë të ndihesh i pafuqishëm përballë padrejtësive shumë të fuqishme.

Por kjo pyetje, "kush jemi ne", ka një përgjigje e cila përjetësisht do jetë burim i pashtershëm i fuqisë sonë për të bërë të pamundurën të mundur. Ne jemi shqiptarë!

Sepse, sepse ne jemi shqiptarë dhe qëndrojmë e luftojmë të pamposhtur për dinjitetin tonë. Sepse ne jemi shqiptarë, luftojmë dhe qëndrojmë të vendosur për familjet tona. Ne jemi shqiptarë, ndaj edhe luftojmë në kushtet më të pabarabarta për kombin tonë, dinjitetin dhe lirinë e tij. Ne jemi shqiptarë, ndaj edhe nuk dorëzohemi. Prandaj ditë si kjo, të pamundurat ne i bëjmë të mundura. Zoti u bekoftë!

Kjo ditë shënon pra një nga ato raste, forca e të keqes që të gjithë e njohim, në një agresion të padrejtë ndaj dinjitetit tim, më mohoi hyrjen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës 4 vite më parë. Në një kohë kur unë isha tetë vite pa asnjë pushtet, thujse i tërhequr plotësisht nga jeta politike. Por me fuqinë që na karakterizon ne si shqiptarë, me besimin e palëkundur tek Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vlerat mbi të cilat është ndërtuar ky vend e komb i madh..

Vend i të lirëve, shtëpi e guximtarëve. I qartë se kristali se kjo padrejtësi nuk po vinte nga Shtetet e Bashkuara, por po vinte nga agjendat antiliri, antikomb, të asaj që vetë presidenti Donald Trump e ka emërtuar si ekstremi i majtë.

Duke mbajtur në mend shprehjen e një prej burrave më të ndritur dhe legjendarë të kombit të madh amerikan, Abraham Lincoln, i cili thotë se "rëndësi nuk ka sa herë rrëzohesh, por sa herë ngrihesh". Dhe unë vendosa të ringrihem. Vërtet e nisa këtë betejë në pamje të parë në pamundësi të plotë, një terr, pa asnjë natë, asnjë natë nuk zgjat dot pafundësisht. Në të njëjtën kohë që unë zhvillova këtë betejë, populli i madh amerikan vendosi të ringrihet, duke zgjedhur si president Donald Trump në nëntor të vitit 2024. Pak nga pak, bota e lirë filloi të ringrihet nga agresioni i ekstremit të majtë dhe efektet erdhën deri në Shqipëri.

Ata që na treguan ne barin përfunduan të papunë, ata që firmosën ndalimin tim sot janë non-grata vetë në vendin e tyre, ata që përgatitën mashtrimet ndaj meje në Shqipëri sot janë prapa hekurave.

Ndërsa unë sot po qëndroj me dy këmbë mbi atë tokë që ata mendonin të ma ndalonin përgjithmonë. Ndaj dhe unë sot kam një mirënjohje të pakufishme ndaj jush, burra, gra, djem dhe vajza, shqiptarë të vërtetë që më mbështetët në orët më të vështira.

Mirënjohje të pakufishme ndaj administratës së presidentit Donald Trump, sekretarit të Departamentit të Shtetit, Marco Rubio, për vendimin e tij.

© SYRI.net

Lexo edhe:

- [Dita e 99-të e protestave kundër Ramës, qytetarët nisin marshimin: Dorëheqje](#)
- [Berisha në Amerikë: Pa qeveri teknike, do të ketë vetëm farsë elektorale, Rruga e vetme largimi i Ramës](#)
- [Protestuesi thirrje Ramës: Hap rrugën të parakalojë rinia jonë! Mallkuar ata që vjedhin popullin](#)

Më të lexuarat

[Politikë](#)

[‘Divjaka bashki!’/ 36 ditë protestë kundër reformës territoriale, banorët akuza deputetes së PS](#)

[Politikë](#)

[Baçi publikon videon: Një tjetër vatër zjarri kërkon ndërhyrje urgjente në Frakull, para se të jetë shumë vonë](#)

[Politikë](#)

[‘Lironi çunat, lironi gocat’/ Pas fjalimeve para Kryeministrit, nis marshimi në rrugët e Tiranës](#)

[Politikë](#)

[Skandal/ Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi fsheh zjarrin dramatik në Himarë](#)

[Politikë](#)

[Spahia: Nga ‘Shqipëria që Duam’ te ‘Pasqyra Albania’ dhe ‘Besa’: nisma të reja, hajdutë të vjetër!](#)

[Politikë](#)

[Nesër masat e sigurisë për 14 protestuesit e arrestuar, protestë para gjykatës së Tiranës](#)

[Politikë](#)

[A ka funksionuar liria edhe për ju?/ Berisha: Në mënyrën më të fuqishme](#)

[Politikë](#)

[Mbyllet dita e 97-të e protestave kundër Ramës, qytetarët paralajmërojnë: Rrethojmë kryeministrinë dhe parlamentin](#)

[Politikë](#)

[Berisha në SHBA/ Ja salla ku do të mbahet takimi i liderit të opozitës me shqiptarët në New Jersey](#)

[Politikë](#)

[Protestat/ Berisha: Rama ne panik urdhëron censurën](#)

TË NGJASHME

[Politikë](#)

[Dorëheqje! Dorëheqje! 99 ditë protestë kundër qeverisë Rama](#)

[Politikë](#)

[‘Vizita e Berishës në SHBA’/ Nesho: U rikthye si sfidant i narkoshtetit! Rama është tërbuar](#)

[Politikë](#)

[Berisha nga SHBA: Ky rikthim do të përdoret, për ndërtimin e një bashkëpunimi të shkëlqyer me SHBA](#)

[Politikë](#)

[Thirrja e Berishës nga SHBA: Diaspora të bashkohet me protestën qytetare në Shqipëri për largimin e Ramës](#)

[Politikë](#)

[Shqiptari i SHBA- së i drejtohet Berishës: Je figura më e pastër që ka pasur Shqipëria në 30 vitet demokrati](#)

[Politikë](#)

Berisha në SHBA, shqiptarja e Amerikës: E vutë këmbën i pari për demokracinë e gjithë Shqipërisë

[Politikë](#)

Berisha: Beteja jonë për Shqipërinë. Kam besim se SHBA do ndihmojnë shqiptarët kundër narkoshtetit

- [Lajme](#)
 - [Web TV](#)
 - [Kuriozitete](#)
 - [Arte & media](#)
 - [Sociale](#)
 - [English](#)
 - [Shëndet](#)
 - [Tjera](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Botë](#)
 - [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Shkencë](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Botërori 2026](#)
- [Jetë/stil](#)
- [Trashëgimi](#)
 - [Histori](#)
- [Mjedis](#)
 - [Klimë](#)
- [Arkiva](#)

SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

[Denonco](#)

Merrni lajmet më të fundit nga SYRI.net në çdo moment dhe kudo që të jeni!

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.